



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 31

Ndërtesa e Kuvendit, salla S - 1

Prishtinë, më 11.5. 2016, në orën 11:00

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË**  
**DHE MIRËQENIE SOCIALE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fikrim Damka, Hatim Baxhaku, Fadil Beka, Mirjeta Kalludra dhe Adem Hoxha.

**Munguan:** Flora Brovina, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Agnesa Haxhiu – KDI, Berim Kodra – Shoqata e Pacienteve dhe mediat.

**Stafi Mbështetës i Komisionit:** Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

**Mbledhjen e kryesoi,** Fikrim Damka, zëvendëskryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**REND I DITËS:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 04.05.2016;**
- 3. Monitorimi i Ligjit të Shëndetësisë;**
  - Identifikimi i obligimeve që parasheh Ligji i Shëndetësisë për Qeverinë, institucionet publike dhe private;
  - Përputhshmëria e akteve nënligjore me ligjin;
  - Plani i vizitave në teren;
- 4. Të ndryshme.**

*Zëvendës kryetari i Komisionit, Fikrim Damka, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 04.05.2016;**

*Zv.kryetari, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtura më 04.05.2016, pa vërejtje.*

### **3. Monitorimi i Ligjit të Shëndetësisë;**

*Zv.Kryetar i Komisionit, vazhdojmë me piken e tretë, si komision sipas planit të punës kemi paraparë që të monitorojmë Ligjin e Shëndetësisë dhe e kemi miratuar planin e veprimit për monitorim. Po ashtu kemi filluar me identifikimin e obligimeve që parasheh Ligji i Shëndetësisë, deri me tani janë nxjerrë disa akte nënligjorë mirëpo edhe një pjesë e madhe e akteve nënligjorë që parashihen me këtë ligj ende nuk janë nxjerr nga Ministria e Shëndetësisë. Grupi punues do të analizoje përputhshmërinë e akteve nënligjore me ligjin si dhe do të kërkojmë një sqarim shtesë nga Ministria e Shëndetësisë , pse edhe aktet tjera ende nuk janë nxjerr. Grupi punues besoj se shumë shpejt do të përgatisë edhe planin e vizitave në teren ku do ti takojmë fillimisht ministrin e shëndetësisë, sekretarin, departamentin ligjorë të kësaj ministrie, mandej drejtorin dhe Bordin e SHSKUK-së si dhe vizita në terren nëpër spitale ku nga afër do të shohim se sa është duke u zbatuar ky ligj dhe ku janë problemet reale në zbatim. Urdhëroni ka dikush diçka të shtojë ?*

**Hatim Baxhaku**, faleminderit i nderuar zv.kryetar të nderuar koleg deputet. Ashtu siç potencuat edhe ju është një ligj sfidues dhe sipas këtij ligji parashihen që të nxirren edhe shumë akte nënligjorë ku para nesh kemi një listë të akteve nënligjorë të cilat janë nxjerre deri me tani si dhe listën tjetër që parashihen edhe një numër i madhe i akteve nënligjorë të cilat nuk janë nxjerr nga Ministria e Shëndetësisë. Si grup punues sigurisht që do të kemi ma lehtë gjatë punës dhe vizitave në teren se ku do të fokusohemi dhe çka do të kërkojmë nga ta si dhe ti evidentojmë saktë problemet në zbatim të këtij ligji.

*Zv.Kryetar i Komisionit, ka dikush diçka tjetër të shtoj ? Jo, atëherë besoj se shumë shpejt do të kemi edhe planin e vizitave apo takimeve në teren. Pas takimeve që do ti realizojmë besoj se do të realizojmë edhe një tryezë ku me gjithë akterët do ti diskutojmë të gjeturat që i kemi hasur me terren dhe rekomandimet se si do të veprojmë me tej. Ligji i Shëndetësisë është miratuar që dy vite dhe ka filluar së zbatuari mirëpo janë hasur disa vështirësi në zbatim të tij sidomos në funksionimin e Shërbimit Spitalor, Klinik Universitar të Kosovës - SHSKUK-së. Këtë vit ju e dini që edhe Agjensioni i Financimit Shëndetësor-AFSH-ja do të funksionalizohët po ashtu edhe Sigurimet Shëndetësorë do të funksionalizohën pra të gjitha këto lidhen me ligjin e shëndetësisë. Besoj se gjetjet dhe rekomandimet tona që do të dalin pas monitorimit, do të adresojnë problemet, në mënyrë që ky ligj të zbatohet më mirë e pse jo nëse vlerësohet që duhet të ndryshohet – plotësohet, ne do të rekomandojmë një gjë të tillë.*

#### 4. Të ndryshme.

**Zv.Kryetar i Komisionit**, vazhdojmë me të ndryshme, a ka dikush diçka të kjo pikë ? Jo, atëherë para jush keni raportin e vizitës zyrtare që kemi realizuar në Turqi lidhur me Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent. A ka dikush diçka të shtoj apo plotësoj këtë raport jo atëherë votojmë:

**Komisioni**, pas prezantimit të raportit, gjithë deputetet njëzëri miratuan raportin e vizitës zyrtare në Turqi, komisioni nxori këtë:

#### **Përfundim**

Miratohet raporti i vizitës zyrtare në Turqi dhe procedohet me tej për njoftim Kryesisë së Kuvendit dhe deputeteve.

**Zv.Kryetar i Komisionit**, a ka dikush diçka tjetër Jo. Atëherë e mbyllim mbledhjen. Ju falënderoj për kontributin tuaj!

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**zv. kryetari i Komisionit,**

---

**Fikrim Damka**